

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU AGENCIJU

**ASC-09-0089**

Në padinë e

Parashtruesit e ankesave

1. [REDACTED]
2. [REDACTED]
3. [REDACTED]
4. [REDACTED]

kundër

I Padituri/Ankuesi

**Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**

Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), Kolegji i Ankesave, i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 04 shkurt 2010 lëshon këtë

**A K T V E N D I M :**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Aktvendimi i Trupit Gjykues (SCEL-09-0003) i datës 21 tetor 2009,  
vërtetohet.

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Më 16 tetor 2009, Trupi Gjykues lëshoi një aktvendim për lëndën nr. SCEL-09-0003, me të cilin e shpalli të pavlefshme listën e punëtorëve me të drejtë legjitime në pjesëmarrje në të ardhurat nga privatizimi. Trupi Gjykues më tutje i ndali procedurat në këtë lëndë dhe udhëzoi Ankuesin/të Paditurin që të publikojë një listë të re sipas ligjit.

Ankuesi/i Padituri ushtroi ankesën e tij kundër këtij aktvendimi më 20 nëntor 2009.

Ankuesi/i Padituri konteston aktvendimin e Dhomës së Posaçme për të shpallur të pavlefshme listën e punëtorëve me të drejtë legjitime në pjesëmarrje në të ardhurat nga privatizimi dhe për të udhëzuar atë që të përgatisë dhe të publikojë një listë të re sipas ligjit. Ai argumenton se aktvendimi përmban shkelje të RREG UNMIK-ut 2008/4 dhe pohon fakte dhe dëshmi të reja përkatëse. Ai pohon, se organi administrativ i shkallës së parë kishte kontaktuar të gjithë punëtorët duke pasë parasysh se kë kishte konsideruar të nevojshëm sepse ata nuk kishin ofruar dëshmi, respektivisht informacione, të mjaftueshme. Në atë kohë, ai kishte qenë i vetmi organ administrativ. Ai thekson se pas aktvendimit të kontestuar dhe pas krijimit të Komisionit për Shqyrtimin e Listës së Punëtorëve lista ishte rishikuar dhe nuk kishte pasur ndryshime krahasuar me listën e mëparshme.

Më tej Ankuesi/i Padituri pohon veçanërisht se ishte udhëzuar nga Dhoma e Posaçme në lëndën SCEL-09-001 (Ramiz Sadiku) që nuk ishte nevoja që të ri-publikohej lista. Ai pohon se Dhoma e Posaçme në këtë mënyrë ka bërë precedent. Prandaj, Ankuesi/i Padituri kërkon të ndryshohet aktvendimi i Trupit Gjykues në atë mënyrë që ri-publikimi i listës së re është i panevojshëm.

### **Arsyet ligjore:**

Ankesa është e pranueshme por e pabazuar. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave vendosi që të refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Neni 67.5 i Urdhëresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6 përcakton se lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime, e vendosur nga Bordi i Drejtoreve në pajtim me nenin 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13 dhe e krijuar sipas neneve 67.2 deri te 67.5 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, do të publikohet në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kjo do të thotë se kërkesat për një listë të vlefshme janë:

- Vendimi i Bordit të Drejtoreve në pajtim me nenin 10.21 të RREG UNMIK-ut 2003/13.
- Publikimi në pajtim me nenin 10.3 të RREG UNMIK-ut 2003/13 që do të thotë publikimi në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetat kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetat kryesore në gjuhën serbe.

Lista është në pajtim me nenin 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13 nëse është shqyrtuar dhe rregulluar nga Agjencia.

Pasi që AKM-ja si agjenci e cila, në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë, duhet të jetë ajo që duhet të merret me Privatizimin e NSH-ve dhe shpërndarjen e 20% tek punëtorët me të drejta legjitime nuk funksionon më në këtë fushë të përgjegjësive, dhe pasi që Ankuesi ka marrë përgjegjësitë në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) (Ligji Nr. 03/L-067) (jo drejtpërdrejtë në fuqi) Dhoma e Posaqme i pranon aktivitetet e AKP-së si një realitet i qartë për t'iu mundësuar punëtorëve të përfshirë në procesin e privatizimit që të kenë qasje efektive në gjykatë në kuptim të nenit 6 të KEDNJ. Kjo nuk do të thotë dhe nuk mund të thotë, se Dhoma e Posaqme e pranon Ligjin e AKP-së si ligj në fuqi në Kosovë, por për të siguruar një proces privatizimi të sigurt dhe të drejtë ky "Ligj" i AKP-së duhet të konsiderohet si rregulla të brendshme të organizatës të vlefshme dhe detyruese brenda procesit të privatizimit. AKP-ja, faktikisht duke

vepruar si pasardhëse e AKM-së në fushën e privatizimit, kështu duhet- së paku në këtë kontekst – të respektojë rregullat e vendosura në ligjin e AKP-së.

Neni 24.1 i Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) (Ligji Nr. 03/L-067), në bazë të të cilit është themeluar AKP-ja si entitet faktik, agjencia do të themelojë Komisionet e Shqyrtimit. Këto komisione të shqyrtimit do të kenë tre anëtarë, një prej të cilëve do të jetë anëtar ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (neni 24.2 i Ligjit mbi AKP-në). Ky person e kryeson Komisionin e Shqyrtimit (neni 24.2 i Ligjit mbi AKP-në). Çdo person i dëmtuar nga një veprim ose lëshim i Agjencisë ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim për shqyrtimin e veprimit ose vendimit nga Komisioni Shqyrtues. Neni 24.7 i Ligjit mbi AKP-në përcakton se secili vendim përfundimtar i Agjencisë, duke përfshirë Komisionet e saj të Likuidimit, mund të kundërshtohet para Dhomës së Posaçme. Kjo tregon se AKP-ja ka organizuar rishikimin e saj të brendshëm në kuptim që Komisioni i Shqyrtimit siç theksohet në ligj është përgjegjës për shqyrtimin në bazë të nenit 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13 dhe se lista është përfundimtare vetëm atëherë kur të jetë shqyrtuar nga Komisioni për Shqyrtim.

Në këtë rast vet Ankuesi/i Padituri thekson se Komisioni për Shqyrtim nuk ka ekzistuar në kohën e shqyrtimit të parë në këtë lëndë (për listën e cila eventualisht është publikuar në bazë të nenit 10.3 të RREG UNMIK-ut 2003/13) dhe se lënda ishte shqyrtuar nga organi administrativ i shkallës së parë. Kjo nuk është në pajtim me ligjin që themelon AKP-në. Prandaj lista mund të konsiderohet e shqyrtuar në pajtim me nenin 10.2 të RREG UNMIK-ut 2003/13. Vet ankuesi duket se e pranon këtë, pasi që nuk e konteston me ndonjë argument vendimin e shkallës së parë lidhur me këtë çështje.

Lidhur me listën e shqyrtuar nga Komisioni i Shqyrtimit pas themelimit të tij, dhe të cilën Ankuesi pohon të ketë plotësuar kushtet e lartpërmendura për një shqyrtim të vlefshëm të listës, kushtet e publikimit në bazë të nenit 10.3 të RREG UNMIK-ut 2003/13 nuk janë plotësuar. Fakti se listat ishin identike nuk është relevant, sepse lista është përfundimtare vetëm kur të jetë shqyrtuar.

Lidhur me publikimin e listës përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime pas themelimit të Komisionit të Shqyrtimit, Ankuesi/i Padituri i referohet SCEL-09-001 (Ramiz Sadiku) si precedent. Në SCEL-09-001 (Ramiz Sadiku), Kolegji i Ankesave nuk është marrë asnjëherë me çështjen e ngritur në këtë rast, sepse Ankuesi/i Padituri e kishte tërhequr ankesën e tij. Prandaj, Ankuesi/ i Padituri nuk mund të kërkojë paqëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore. Është me rëndësi të përmendet se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme nuk kufizohet në vendimet e dhëna nga Trupi Gjykues i Dhomës së Posaçme, ashtu sikurse Trupi Gjykues që nuk kufizohet në vendimet e tyre të mëparshme.

Prandaj ankesa refuzohet si e pabazuar. Aktvendimi i dhënë nga Trupi Gjykues më 16 tetor 2009 mbetet në fuqi. Nuk është marrë vendim lidhur me shpenzimet.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it nënshkruar

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it nënshkruar

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it nënshkruar

Tobias Lapke, Regjistrues i EULEX-it nënshkruar